

URDHËR
Nr. 8045, datë 7.12.2016

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, të pikës 4, të Kushtetutës, nenit 7, pikës 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 8.12.2016, ora 14:00, deri në datën 11.12.2016, ora 18:00, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Eridian Salianji.
 2. Ngarkohet zëvendësministri, z. Eridian Salianji, për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani